

	Emri i institucionit: <b>DREJTORIA E PËRGJITHSHME E STANDARDIZIMIT</b>	Dokumenti Nr.: <b>RC/DS/117</b>	
	Titulli: <b>Plani strategjik i biznesit për DPS/KT</b>	Versioni: <b>01</b>	Faqe Nr.: <b>Faqe 1/3</b>

*PSB, 24.11.2021*

## **Titulli i DPS/KT:**

### **DPS/KT 52 “Siguria e Lodrave”**

#### **A Historiku**

DPS/KT 52 është krijuar në 14.02.2002, në përputhje me Ligjin Nr. 9870 “Për Standardizimin”, i ndryshuar dhe rregulloret e brendshme të DPS në përputhje me rregulloret/udhëzuesit dhe strategjitë e CEN/CENELEC dhe ISO/IEC, mbi krijimin dhe funksionimin e Komiteteve Teknike.

Fusha e këtij KT është adoptimi i standardeve evropiane dhe ndërkombëtare CEN/ISO si dhe hartimi i standardeve shqiptare në lidhje me kërkesat e sigurisë së lodrave në të gjitha aspektet duke u fokusuar në lodra tradicionale. Brenda fushëveprimit të këtij KT një rëndësi e madhe i jepet dhe standardeve të sigurisë së vetive fizike dhe mekanike të lodrave si dhe vetive të ndezshmërisë.

#### **B Mjedisi i biznesit**

##### **B.1 Të përgjithshme**

Puna e DPS/KT 52 vazhdon me një ritëm të shpejtë për shkak të rritjes së përdorimit të lodrave që bien në fushën e këtij KT si dhe për shkak të përdorimit të tyre nga gjithë fëmijët në mbarë botën nga mosha e lindjes deri në 14 vjeç. Pjesa më e madhe e standardeve të adoptuara nga ky KT janë standarde të harmonizuara nën Direktivën 2009/48/EC. Në kuadrin e përmbushjes së detyrimeve për anëtarësim në CEN/CENELEC dhe duke u bazuar edhe në strategjinë e DPS është i detyrueshëm adoptimi 100% i standardeve nën këtë Direktivë. Standardet e adoptuara nga ky KT janë të rëndësishme pasi dhe në shumë vende të tjera të botës dhe në Shqipëri ekziston një vetëdije e madhe për rëndësinë e sigurisë së lodrave në nivel komuniteti për të menaxhuar rrezikun e lodrave të cilat shoqërohen me kimikate ose lënde të tjera helmuese.

##### **B.2 Treguesit sasiore të mjedisit të biznesit**

Përdoruesit e standardeve të adoptuara nga DPS/ KT 52 dhe palët e interesit të përfshira direkt në procesin e standardizimit brenda këtij KT janë industria e lodrave, konsumatorët, përfaqësimet e drejtpëdrejta nëpërmjet shoqatave të konsumatorit, përfaqësues të autoriteteve qeveritare ose lokale përmes zbatimit të agjensive përkatëse, organizmat e certifikimit, laboratorët e testimit, shitësit dhe institucionet kërkimore .

Standardet e adoptuara nga ky KT kanë përdorim të gjerë dhe synojnë

- përmirësimin e cilësisë së produktit;
- kontrollin e prodhimit;
- sigurinë e cilësisë
- përmirësimin e konkurrencës;
- ndihmën në globalizimin e ekonomisë të bazuar në konkurrencë;

	Emri i institucionit: <b>DREJTORIA E PËRGJITHSHME E STANDARDIZIMIT</b>	Dokumenti Nr.: <b>RC/DS/117</b>	
	Titulli: <b>Plani strategjik i biznesit për DPS/KT</b>	Versioni: <b>01</b>	Faqe Nr.: <b>Faqe 2/3</b>

## C Përfitimet

Puna e KT 52 duhet të rezultojë në adoptimin e standardeve që do të mundësojnë:

- zhvillimin e tregtisë së madhe të lodrave në nivel ndërkombëtar dhe rajonal;
- mirëmbajtjen e standardeve evropiane dhe ndërkombëtare në lidhje me kërkesat e sigurisë dhe metodave të provave;
- mbështetjen për legjislacionin evropian;
- përcaktimin e sigurisë së lodrave në nivel ndërkombëtar dhe rajonal.

## D Pjesëmarrja në DPS/ KT 52

Në DPS/KT 52 ka përfaqësues nga institucione publike, shoqatat e konsumatorëve dhe nga Drejtoria e Doganave e, e cila merret direkt me kontrollin e tregut mbi transportin e ngarkesave (nëpërmjet bagazheve adresave postare etj). Palët e interesuara në raste të veçanta për probleme specifike mund të emërojnë ekspertët e tyre në grupet e punës të ngritura nga KT për çështje specifike.

## E Objektivat dhe strategjitë

### E.1 Objektivat e përcaktuara nga DPS/ KT 52

- Një ndër objektivat kryesore të DPS/KT 52 është miratimi i standardeve, në përputhje me procedurat për hartimin dhe adoptimin e standardeve shqiptare dhe dokumentet e tjera të standardizimit, për mirëmbajtjen e standardeve të sigurisë së lodrave të cilat lidhen ngushtë me vetitë fizike, mekanike, kimike dhe me vetitë e ndezshmërisë të tyre të cilat mbulohen nga ky KT, duke përgatitur çdo vit programin e punës së KT;
- Përfaqësimi i interesave kombëtare në organizmat evropiane dhe ndërkombëtare kur ajo kërkohet;
- Aplikimi i parimeve themelore të standardizimit;
- Përgatitja dhe pasurimi me terma të reja të fushës i fjalorit terminologjik;
- Marrja në konsideratë e aspektit mjedisor kur ajo kërkohet sipas rasteve specifike;
- Bashkëpunimi i frytshëm me organizmat evropiane dhe ndërkombëtar si dhe në nivel rajonal.

### E.2 Strategjitë e përcaktuara për arritjen e objektivave

Përmbushja e objektivave të DPS/KT 52 bazohet në punën për adoptimin e standardeve evropiane dhe ndërkombëtare si standarde shqiptare, duke bashkëpunuar me KT "pasqyrë" të CEN dhe ISO si më poshtë:

CEN/TC 52	Siguria e Lodrave
CEN/TC 152	Karuselët dhe zbatimi i veprimeve me anë të makinave lodrat, strukturat - Siguria
CEN/TC 252	Artikuj të përdorimit të kujdesit për fëmijë
CEN/SS H34	Siguria e fëmijëve
ISO/TC 181	Siguria e Lodrave

	Emri i institucionit: <b>DREJTORIA E PËRGJITHSHME E STANDARDIZIMIT</b>	Dokumenti Nr.: <b>RC/DS/117</b>	
Titulli: <b>Plani strategjik i biznesit për DPS/KT</b>		Versioni: <b>01</b>	Faqe Nr.: <b>Faqe 3/3</b>

DPS/KT 52 do të sigurojë mirëmbajtjen e nevojshme të standardeve si dhe rishikimin e standardeve të pranishme nën Direktivën përkatëse .

### **F Planifikimi**

Për realizimin e objektivave të më sipërme ky KT bazuar në propozimin e standardeve të reja fillon punën për adoptimin e standardeve.

### **G Financimi**

Kryetari dhe anëtarët punojnë mbi baza vullnetare dhe pa pagesë

**Sekretari i DPS/KT 52**

**(Elona TELULI)**